# Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

| Nr. | Data e kërkesës | Objekti i kerkeses | Data e përgjigjes | Pergjigje | Menyra e perfundimit te kerkeses | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 05.01.2024 | Kërkesë për informacion në lidhje me pikat e mëposhtme:<br>• Sa eshte vlera totale per ndihme sociale qe eshte dhene per grate/femrat e dhunuara?( Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023);<br>• Sa eshte buxheti i bashkise tuaj per dhunen ne familje? ( Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023)?;<br>• Sa gra/femra te dhunuara kane perfituar subvencionim te qirase/ bonus qiraje nga bashkia juaj? (Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023);<br>•Sa gra/femra te dhunuara kane perfituar kredi te buta per vitet 2020-2021-2022-2023? ( sa kane aplikuar dhe sa e kane perfituar ) ?<br>• Cila eshte problematika me e madhe qe keni ndeshur per te ndihmuar/mbeshtetur , grate / femrat e dhunuara pergjate ketyre viteve ( 2020-2023)? | - | - | - | - |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 29.02.2024 | Informacionin e kërkuar si më poshtë.<br>A keni bere zevendesimin/kalimin e kompetencave ligjore te nje vartesi juaj dhe nese po lutemi na vini ne dispozicion urdherin ne baze te cilit eshte bere zevendesimi. | 06.03.2024 | Derguar shkresa e urdherit te kalimit te kompetencave ligjore te vartesi. | E plote | Nuk ka |
| 3 | 27.03.2024 | Informacion mbi strukturat administrative rinore prane Njesive te Veteqeverisjes Vendore.<br>A ka bashkia juaj strukture administrative per ceshtjet e rinise?<br>A ka te parashikuar ne buxhetin tuaj fonde per realizimin e projekteve,programeve dhe veprimtarive rinore per vitin 2024? | - | - | - | - |
| 4 | 24.04.2024 | Informacion mbi vendosjen e shtatores se heroit Tahir Sinani ne Bajram Curri. | 25.04.2024 | Aktiviteti per vendosjen e shtatores se heroit Tahir Sinani, do te behet me date 05.05.2024 ne Sheshin "Tahir Sinani" Bajram Curri ne oren 12:00. Ne aktivitet do te marrin pjese te ftuar nga Maqedonia,Mali i Zi,Kosova dhe autoritete vendore. | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 09.05.2024 | Informacion lidhur me kapacitetet e emergjencave civile ne bashkine tuaj.<br><br>1.Sa është numri i stacioneve të MZSH në bashkinë tuaj?<br>2.Sa është numri total i makinave zjarrfikëse në bashkinë tuaj ?<br>3.Sa është numri i efektivëve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit ( zjarrfikës dhe punonjës)<br>4. Cilit vit i përkasin automjetet zjarrfikëse dhe a mund të specifikoni nëse janë blerë nga fondet e bashkisë apo donacionet?<br>5. A ka Bashkia plane afatshkurtra për blerje mjetesh të reja apo investime lidhur me këtë program? | - | - | - | - |
| 6 | 04.06.2024 | Informacion mbi punesimin e te rinjeve ne bashkine Tropoje. | - | - | - | - |
| 7 | 04.06.2024 | 1- A mund të na vini në dispozicion formularët e Konfliktit të Interesit të firmosura nga kryetari i | 19.06.2024 | Derguar pergjigje me email,bashkangjitur urdherin e delegimit te firmes te nenkryetari. | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Bashkisë në të gjitha rastet kur ai i ka firmosur nga data 1 janar 2020 deri në datën 1 qershor 2024.<br>2- A mund të na vini në dispozicion Urdhërin e delegimit të firmës tek nënkryetari për të gjitha rastet e tenderave nga data 1 janar 2020 deri në datën 1 qershsor 2024.<br><br>3-Përmes një tenderi me objekt: Rikonstruksion i Thertores Shudenice + Ndertimi i Tregut te Bagetive" është planifikuar ndërtimi i thërtores dhe tregut të bagëtive,<br>A mund të na tregoni që kur ka nisur punë thërtorja dhe aktuaisht a është në proces PUNE. Nderkohe në cfarë lokacioni është ndërtuar tregu u bagëtive sipas këtij tenderi, dhe a janë në të njëjtin ambient edhe tregu edhe thërtorja?<br><br>4-Nga të dhënat e grumbulluara deri më tani rezulton se kompania "Halili 1" me | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | administrator Kujtim Byberi është një ndër përfituesit më të mëdhenj të tenderave para vitit 2019, kohë kur Zoti. Rexh Byberaj ka ardhur në krye të Bashkisë së Tropojës, por pas vitit 2019 kjo kompani rezulton me fitime të paktë dhe me një normë të uëlt të shpalljes fitues në bashkinë e Tropojës.<br>A ka ardhur kjo situatë për shkak të marrëdhënieve të këqija personale të kryetarit të Bashkisë me Z.Kujtim Byberi ? | | | | |
| 9 | 15.07.2024 | Kerkese per infomacion mbi pyllëzimet e kryera nga subjektet që operojnë në energjinë hidrike HEC në territorin e bashkisë suaj nga viti 2008 e deri më sot.<br>1. Sa sipërfaqe janë pyllëzuar?<br>2. Në cilat parcela dhe ekonomi pyjore është bërë investimi?<br>3. A ka patur investime të tjera përveç pyllëzimeve? Nëse po, ku dhe çfarë investimi? | 02.08.2024 | 1- Eshte pyllezuar siperfaqja prej 0.184 ha.<br>2- Eshte pyllezuar siperfaqja pergjate aksit rrugor Qafe Morine-B.Curri konkretisht me llojin bli.<br>3- Pervec pyllezimit me blina dhe selvi brenda qytetit nuk ka pasur te tjera pyllezime. | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | 28.08.2024 | Kërkesë për informacion mbi Festat Lokale 2024<br>-Janar-Gusht 2024<br>-Shtator- Dhjetor 2024 | 03.09.2024 | -Hapja e sezonit turistik ne Valbone ( Maj)<br>-Festa e Bjeshkeve ne Sylbice(qershor)<br>-Pelegrinazhi ne Majen e Shkelzenit (Gusht)<br>Festa e Geshtenjave ne qytet (tetor). | E plote | Nuk ka |
| 11 | 17.10.2024 | Informacion per festen "dita e geshtenjes" | 18.10.2024 | Festa e ditës së gështenjës do të mbahet nesër me datë 19.10.2024 ora<br>10:00 në Chestnut Hill (kodra e gështenjave)<br>Velisht,Geghysen. | E plote | Nuk ka |
| 12 | 22.10.2024 | Kerkese per informacion mbi Fondin Social ne bashkine Tropoje<br>1.A ka bashkia nje Plan Social te miratuar dhe nese po kur eshte miratuar?<br>2.A ka aplikuar Bashkia Tropoje per te perfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues ne vitin 2024?<br>3.Sa ka qene vlera totale e miratuar nga MSHMS per vitin 2024 dhe per cilat kategori sherbimesh do te perdoren?<br>4.A eshte disbursuar ne masen 100% fondi i | 06.11.2024 | Eshte derguar shkresa me informacionin e kerkuar si me poshte:<br>1-Bashkia Tropoje ka nje plan social me afat dy vjecar 2024.2026 te miratuar por te pabuxhetuar.<br>2-Bashkia Tropoje per vitin 2024 nuk ka aplikuar per te perfituar nga Fondet Sociale(arsyeja mungese e buxhetit dhe stafit te mirefillt per te ngritur dhe mirembajtur sherbimin e ngritur.<br>3-Nuk ka aplikime as perfitime fondesh<br>4-Nuk ka fonde Sociale nga MSHMS per vitin 2024. | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kushtezuar i MSHMS per vitin 2024?<br>5.A keni perthithur fonde nga Fondi Social per vitin 2023, ne cfare vlere ka qene fondi i perfituar dhe per cilat kategori sherbimesh jane perdorur?<br>6.Sa perqind te fondit te perfituar keni perdorur deri tani te ndare sipas viteve, 2023 dhe 2024?<br>7.A keni parashikuar ne buxhetin afatmesem 2025-2027 ngritje te fondeve per te mbajtur ne funksion sherbimet e ofruara ne territor edhe pas perfundimit te financimit te Fondit Social?<br>Cilat jane kategorite e shtesave vulnerabel te identifikuara ne bashkine tuaj qe mund te perfitojne nga sherbimet sociale? | | 5-Bashkia Tropoje nuk ka perthithur fonde sociale per vitin 2023 dhe as perfituar fonde sociale per vitin 2024<br>6-Nuk eshte planifikuar fond nga buxheti i bashkise sepse nuk kemi ngritur asnje sherbim nga fondi social.<br>7-Shtresa vulnerabel te identifikuara qe mund te ngrihen sherbime jane:familje ekstremisht te varfra, gra te dhunuara, femije ne rruge, persona me aftesi ndryshe, mosha e trete per persona te vetmuar. | | |
| 13 | 28.10.2024 | 1.Sa është buxheti vjetor i bashkisë tuaj? Sa prej tij shpenzohet për projekte sociale? Ka ndodhur të mbeten fonde pa u shfrytëzuara? (Ju lutem të dhënat për 3 vitet e fundit)<br>2.A keni aplikuar në | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | institucionet qëndrore me projekte në thirrjet që hapen? Sa aplikime keni paraqitur? Sa herë bashkia juaj ka rezultuar fituese? Kur nuk rezultoni fitues, cilat janë arsyet që ju penalizojnë? (të dhënat në shifra 3 vitet e fundit)<br>3.Cili është projekti i fundit që keni aplikuar? Si i hartoni projektet, a keni ekip pune të posaçëm, të trajnuar?<br>4.Në zonën tuaj sa familje ka që trajtohen me ndihmë ekonomike? Sa familje kanë persona që trajtohen me kemp? Sa dhe si ju mund t'i mbështesë bashkia juaj këta persona?<br>5.Sa familje janë të pastreha në bashkinë tuaj? | | | | |
| 14 | 14.11.2024 | Kerkese per informacion mbi vleren e investimeve qe ka bere bashkia per vitin 2024 | 13.12.2024 | Eshte derguar shkresa me informacionin e kerkuar ne rruge postare dhe elektronike. | E plote | Nuk ka |
| 15 | 04.12.2024 | 1-Sa dhoma për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin janë ngritur në bashkinë tuaj dhe<br>ku ndodhen ato? | 27.12.2024 | Pergjigjet jane si me poshte:<br>1. Ne bashkine tone nuk eshte e ngritur asnje dhome per intervistimin e te miturve ne konflikt me ligjin pervec; zyres se punonjeses se mbrojtjes se | E plote | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2) A ka pasur investime për përmirësimin e infrastrukturave që ofrojnë masat alternative për të mitur në bashkinë tuaj? Ku është investuar dhe sa?<br>3) Sa të mitur në konflikt me ligjin kanë marrë masa alternative në bashkinë tuaj, për çdo vit, nga firmosja e marrëveshjes deri me 2024, duke përfshirë ata që janë nën 14 vjeç dhe ata që janë rikthyer në sistemin e drejtësisë penale?<br>4) Sa qendra multifunksionale ka kjo bashki dhe ku ndodhen ato?<br>5) Sa nga qendrat multifunksionale janë adaptuar pas firmosjes së marrëveshjes për të ofruar shërbime për të miturit në konflikt me ligjin, për rehabilitim, mbikëqyrje dhe edukim?<br>6) Sa janë kostot e investuara nga bashkia për riadaptimin e këtyre qendrave multifunksionale nga | | femijes, pasi ka mungese infrastrukture.<br>2. Jo nuk ka patur investime.<br>3. Gjate kesaj periudhe nuk kemi asnje te mitur ne konflikt me ligjin qe ka marre mase alternative.<br>4. Ne territorin e Bashkise Tropoje operon vetem nje gender ne fokus 'Autizmin'.<br>------- 5. Nuk kemi asnje gender multifunksionale per te ofruar sherbime per te miturit ne<br>konflikt me ligj in.<br>6. Nuk kemi asnje kosto ne dispozicion nga Bashkia per te miturit ne konflikt me ligjin.<br>7. Ne territorin e Bashkise Tropoje nuk kemi asnje gender per te ofruar asnje lloj sherbimi duke perfshire mbeshtetje psiko-sociale, arsimore dhe rehabilituese ne lidhje me kete kategori te miturish.<br>8. Ne bashkine tone eshte vetem nje punonjes social ge mbulon mbrojtjen e femijes dhe<br>dhunen ne familje, ge normalisht mundohet ge te ndjeke ag sat e mundet trajnime, por | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | firmosja e marrëveshjes, deri më 2024 për çdo vit?<br>7) Çfarë lloj shërbimesh ofrohen në këto qendra për të miturit, përfshirë mbështetje psikosociale, arsimore dhe rehabilituese?<br>8) Sa punonjës social të trajnuar për të ndjekur të miturit në konflikt me ligjin ka bashkia juaj në 2024?<br>9) Sa të mitur janë dënuar me burgim në Bashkinë Tropojë dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative nga firmoja e marrëveshjes deri më 2024, për çdo vit?<br>10) Sa të mitur nën 14 vjeç janë dënuar me burgim në Bashkinë Tropojë dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative?<br>11) Sa të mitur në konflikt me ligjin nën 14 vjeç janë ndjekur nga punonjës socialë dhe sa janë të përfshirë në programet e mbikëqyrjes dhe rehabilitimit në bashkinë | | ne kete fushe nuk eshet e trajnuar.<br>9. Ne Bashkine Tropoje nuk ka asnje te mitur te denuar me burgim.<br>1 0. Asnje i mitur nuk eshte denuar me burgim ose me masa alternative.<br>11. Te miturit ne konflikt me ligjin jane ndjekur gjithmone nga punonjesja e mbrojtjes se femijes prane Bashkise Tropoje ku dy shkeljet ge keta te mitur kane here kane gene sipas Nenit 279 te KP dhe Nenit 291 te KP.<br>12. Asnje<br>13.Jo<br>14.Me ane te shkresave zyrtare<br>15. Afersisht 25 te mitur sipas Neneve te cituara ne pytjen 11.<br>16. Jo<br>17. Asnje<br>18. Asnje<br>19. Asnje<br>20. Per arsye qe nuk kemi patur raste te te miturve per drejtesine alternative komunikimi ka qene shume i paket me qendrat multifunksionale te adaptuara.<br>21. Nuk eshte transferuar asnje rast pasi nuk ka patur raste | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | tuaj?<br>12) Sa janë të miturit që kanë ndjekur programet e rehabilitimit pas përfundimit të dënimit dhe sa të<br>mitur nga bashkia juaj janë recidivist?<br>13) A keni akses në databazën kombëtare për ndjekjen e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin?<br>14) Si komunikon me databazën kombëtare për të miturit në konflikt me ligjin Bashkia Tropojë?<br>15) Sa raste të të miturve në konflikt me ligjin janë regjistruar në bashkinë tuaj në 5 vitet e fundit?<br>16) A ka bashkia juaj një sistem të vetin për monitorimin e masave alternative për të miturit në konflikt me ligjin?<br>17) Cilat projekte janë realizuar që nga firmosja e marrëveshjeve për drejtësinë alternative për të miturit? Sa kanë qenë kostot e investuara dhe a janë akoma funksionale? | | konkrete. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 18) Sa fonde janë alokuar nga buxheti i bashkisë për zbatimin e këtyre projekteve?<br><br>19) Sa të mitur kanë kryer masa alternative në bashkinë tuaj që prej vitit 2018 për çdo vit?<br>20) Sa efektive është komunikimi mes njësive administrative të bashkisë dhe qendrave multifunksionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të mitur?<br>21. Sa raste nga firmosja e marrëveshjes nga bashkia juaj deri më sot janë transferuar nga njësia bashkiake drejtë qendrave multifunksionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të miturit? | | | | |
| | | | | | | |